

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR POLICINË BASHKIAKE”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për Policinë Bashkiake”

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- efektet e mundshme në zbatimin praktik nga institucionet përkatëse;
- çdo aspekt që mund të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së projektaktit në praktikë.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 18 dhjetor 2025 deri më 15 janar 2026.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji është hartuar me kontribut të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor. Projektligji dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Departamentit të Administratës Publike, Këshillit Konsultativ të Qeverisje Qendrore me Qeverisje Vendore, Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, Shoqatës për Autonomi Vendore, si dhe Shoqatës të Bashkive të Shqipërisë.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Projektligji “Për Policinë Bashkiake” është një instrument thelbësor për modernizimin e shërbimeve të rendit në nivel vendor, ngritjen e një sistemi të qartë drejtimi dhe përgjegjësie, forcon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe garanton rritjen e vazhdueshme të standarteve profesionale, rritjen e sigurisë publike në territor, në funksion të mirëqenies së qytetarëve dhe administrimit të hapësirës publike.

Në këtë kuadër, miratimi i projektligjit është i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave të qeverisjes vendore, promovimin e rendit dhe sigurisë në komunitet, si dhe forcimin e zbatimit të kuadrit ligjor.

Propozimet:

Standartizimi i funksioneve të Policisë Bashkiake në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore,
Koordinim efikas në nivel qendror - vendor,
Rekrutim cilësor dhe transparencë në ecurinë në karrierë,
Rritje e profesionalizmit të punonjësve të Policisë Bashkiake, trajnime të vazhdueshme dhe monitorim i performancës së punonjësve,
Rritje e besimit të publikut dhe bashkëpunimi mes komunitetit me Policinë Bashkiake.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në:

- a.** Rritjen e eficiencës, qartësisë së kompetencave dhe koordinimit operacional të Policisë Bashkiake me institucionet e tjera të rendit dhe administratës publike, në nivel vendor dhe qendror?
- b.** Rritjen e profesionalizmit, standardeve etike dhe besimit të komunitetit ndaj Policisë Bashkiake, përmes rekrutimit, trajnimit dhe monitorimit të performancës së punonjësve?